



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 14 prill 2014, në orën 10:40

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Delegacioni i Komisionit për Politikë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ishte në përbërje nga deputetët: znj. Arta Dade, kryetare e Komisionit, z. Aldo Bumçi, z. Ben Blushi, z. Namik Dokle, znj. Valentina Leskaj, z. Gerd Bogdani, z. Dashamir Shehi, z. Përparim Spahiu anëtarë dhe Krenar Hajderi, staf i Komisionit.

Në takim nga anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme morën pjesë: z. Albin Kurti, z. Hydajet Hyseni z. Enis Kervan, z. Sabri Hamiti, znj. Emilija Rexhepi dhe z. Hamza Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Mentor Boja-IPZHK, Doruntina Gashi-praktikante, Fitore Pacolli-LVV dhe Lumnije Murati-ZPRK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s:

Takimi me delegacionin e Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Albin Kurti fillimisht i dëshiroi mirëseardhje delegacionit të KPJ të Kuvendit të Shqipërisë në Kuvendin e Kosovës dhe në këtë takim, për të cilin tha se është vazhdimësi e komunikimeve dhe bashkëpunimit në mes të dy komisioneve. Një takim të kësaj natyre, tha se KPJ i Kuvendit të Kosovës e realizoi në Shqipëri më 2011. Në diskutimin e tij z. Kurti tha se Komisioni në vitin 2011, mori nismën për përfaqësim të përbashkët të Kosovës dhe Shqipërisë në ambasada e konsullata. Kjo nismë tha ai, u shndërrua në marrëveshje dhe hyri në fuqi në prill të vitit 2012, por e reduktuar. Kurti theksoi se nuk do të duhej të ekzistonin dallime në sferën e politikës së jashtme

për përfaqësimin e jashtëm, dhe bashkëpunimi po ashtu do të sillte një kosto shumë më të ulët financiare për veprim.

Arta Dade falënderoi për ftesën që i është bërë delegacionit të KPJ të Shqipërisë, për këtë vizitë. Ndër detyrat parësore të KPJ-së, tha ajo, është ndjekja e dinamikës në fushën e politikës së jashtme të Shqipërisë. Lidhur me integrimin në strukturat euroatlantike, Dade tha se është realizuar integrimi i plotë në NATO dhe mbeten të përmbushen detyrimet që burojnë si vend anëtar i NATO-s, e po ashtu detyrë tjetër është nxitja e qeverisë shqiptare për përmbushjen e detyrimeve nga agjenda evropiane.

E mbështesin avancimin në bashkëpunimin e përfaqësive diplomatike dhe se çdo hap i politikës së jashtme të ministrisë, do ta ketë mbështetjen e KPJ shtoi Dade dhe shprehu dëshirën që Kosova të avancohet në procesin e integritimit evropian, në procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa përshëndeti shndërrimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, në Forca të Armatosura të Kosovës, duke theksuar se do të ofrojnë përvojën e tyre në agjendën e Kosovës, për integrim në NATO.

Aldo Bumçi përgëzoi Qeverinë e Kosovës për arritjet në politikën e jashtme, për hapjen e bisedimeve për procesin e liberalizimit të vizave, negociimin e procesit të stabilizimit asociativ, dhe arritjen e statusit të vëzhguesit në Asambleenë Parlamentare. Ai theksoi edhe rëndësinë e bashkëpunimit me diasporën dhe mbikëqyrjen e ministrive në zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Bumçi kërkoi të informohet nga anëtarët e Komisionit se si tani me ndryshimet në qeverinë serbe e shohin vazhdimin e dialogut me Serbinë, dhe se a mund të kenë ndikim në Ballkan ngjarjet në Ukrainë dhe si shihet propozimi për formimin e Gjykatës Speciale, cilat janë argumentet për ngritjen e saj.

Albin Kurti duke u ndërlidhur me çështjet e shtruara, njoftoi se në strategjinë kombëtare të mbrojtjes të Serbisë, Kosova definohet si rreziku kryesor dhe ata veprojnë në bazë të kësaj premise dhe se në kushtetutën e tyre Kosova është pjesë integrale e Serbisë. Kurti bëri të ditur se Serbia vazhdon të financojë strukturat e ndryshme paralele, e nga më të rrezikshmet, janë ato që vijnë nga sektori i sigurisë dhe kanë shef të drejtpërdrejtë Ivica Daçiqin. Kurti tha se është duke ju bërë një padrejtësi e madhe Kosovës e shqiptarëve, përderisa 150 mijë jo serbë janë vrarë nga forcat ushtarake e paramilitare serbe, në katër luftërat në ish Jugosllavi, pra 30 mijë vrasës serik shëtisin të lirë dhe e kanë fituar liberalizimin e vizave. Formimi i Gjykatës speciale, tha Kurti ka rezultuar si pasojë e propagandës së madhe të Serbisë gjithandej në perëndim dhe do të vijë për ratifikim si marrëveshje në mes të Presidentes Jahjaga dhe baroneshës Eshton, në fund të kësaj jave. E veçanta e kësaj gjykate është se nuk ka afat veprimi, ndërsa për pretendimet e Dick Marty, tha se ato do të mund t'i hetonte EULEX-i. Kurti theksoi se nuk ka analogji në mes të Kosovës dhe Krimesë dhe shtoi se duhet ngritur niveli i partneritetit me miqtë ndërkombëtarë, i cili duhet të reflektojë në dy fusha, atë ekonomike e ushtarake.

Valentina Leskaj duke përshëndetur të arriturat e Kosovës, theksoi se edhe Kosova edhe Shqipëria kanë rrugë të gjatë për të bërë sa i përket procesit të integritimeve evropiane. Ajo njoftoi për lobimet e bëra atje, për njohjen e Kosovës, Komisionin e Venecias dhe për integrimin e Kosovës, duke shtuar se hapësirën të cilën e disponojnë në Këshillin e Evropës, mund ta ndajnë me Kosovën.

Hydajet Hyseni në diskutimin e tij theksoi nevojën që ka Kosova për ndihmën në përvojë dhe mbështetjen nga jashtë, e sidomos atë të Shqipërisë. Ky takim tha se padyshim do të ndikojë në intensifikimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Hyseni shprehu mirënjohje për ndihmën e ofruar nga

Shqipëria, kujdesin e veçantë dhe angazhimin e pakursyer karshi Kosovës. Duke u ndërlidhur me raportin e Dick Marty, ai theksoi se për Kosovën janë shkruar raporte pa Kosovën, për të cilën çështje është dashur një angazhim më i madh yni. Sa i përket dialogut me Serbinë, ai tha se në Prishtinë ka pasur prirje që ky dialog të quhet dialog teknik, por në Beograd nuk është quajtur i tillë dhe për pasojë Prishtina është mjaftuar me disa ndryshime të natyrës teknike, ndërsa Beogradi ka marrë koncesione serioze. Hyseni shtoi se i dëshirojmë ndryshimet pozitive në Serbi sepse do të ishin në favor të Kosovës dhe rajonit në përgjithësi, duke u shprehur se:” luftën për fat të keq nuk e kemi tejkaluar, ka ndryshuar forma por vazhdon të jetë e egër, brutale, kërcënuese dhe për mendimin tim nuk lidhet vetëm me një pjesë të hapësirës shqiptare por edhe më gjerë. Vetë fakti që është krijuar një qëndrim i pakuptueshëm jo vetëm nga qendrat ndërkombëtare të vendosjes por deri edhe nga ne, madje edhe nga Shqipëria që të ashtuquajtura standarde evropiane të implementohen në kulte të ndryshme, diçka që imponohet në Kosovë injorohet jashtë Kosovës, diçka që kërkohet në pjesën jugore të Kosovës injorohet në veri ose e kundërta”. Standardet evropiane, tha se duhet vërtetë të vlejë dhe të standardizohen.

Në vazhdim diskutuan deputetët e delegacionit të Shqipërisë: Ben Blushi, Namik Dokle e Gerti Bogdani, të cilët mes tjerash shprehën nevojën e intensifikimit të kontakteve, nevojën për reforma strukturore si dhe u interesuan për çështjen e nismës së BE-së për Ballkanin Perëndimor”G-6”.

Albin Kurti lidhur me iniciativën për Ballkanin Perëndimor ”G-6”, tha se këto solucione nuk janë të mira. Ky është solucion i ndërmjetëm i BE-së, për vendet e Ballkanit Perëndimor deri në integrimin e tyre në BE, selia qendrore e të cilit do të ishte në Beograd.

Kryetari i Komisionit z. Albin Kurti dhe Kryetarja e KPJ të Kuvendit të Shqipërisë, në fund të takimit potencuan nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit në të ardhmen me ç’rast znj. Arta Dade ftoi anëtarët e Komisionit, për një vizitë në Shqipëri.

Takimi përfundoi në orën 11:45.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

